



**ANJA
HYSA**

***Një ndihmë e vogël nga Zyra e
Këshillimit të Karrierës në
momentin e duhur***

Në vitin e parë të studimeve Bachelor, Anja, studente e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Departamenti Gazetari dhe Komunikim, u përball me një mundësi që nuk donte ta humbiste. Një nga televizionet më të njohura në vend kishte hapur aplikimet për praktikantë. Ajo ndjeu menjëherë dëshirën për të provuar, por edhe një pasiguri të madhe.

“Kur na u dha njoftimi për një vend praktike në një nga televizionet më të mëdha në vend, ndjeva menjëherë një përzierje emocionesh: dëshirë, entuziazëm... dhe një frikë të lehtë. Një pyetje më trokiste në kokë: “Si do aplikoj unë? Me çfarë CV-je?” Nuk kisha asnjë përvojë pune. Nuk ndihesha gati”.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:



HELVETAS



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Ishte pikërisht në atë moment që iu kujtua një takim i semestrit të parë, kur një këshilluese karriere me emrin Blerina kishte hyrë në auditor për të prezantuar shërbimet që ofron Zyra e Këshillimit të Karrierës. Me tone të qeta dhe miqësore, kishte thënë: *"Kur të keni nevojë, ejani. Jemi këtu për t'ju ndihmuar."*

"Ishte pikërisht ai moment që më erdhi në mendje ajo ditë nga viti i parë. Blerina, këshilluese karriere, kishte ardhur në klasë dhe na kishte folur për Zyrën e Karrierës: një vend ku mund të gjenim ndihmë, udhëzim dhe mbështetje për gjithçka që kishte të bënte me orientimin profesional. "Kur të keni nevojë, ejani", fjalë që më kishte mbetur në mendje. Dhe tani, më në fund, erdhi ajo ditë".

Zyra ndodhej në godinën e fakultetit, por deri atëherë, studentja e kishte kaluar çdo ditë përpara saj pa u ndalur. Deri në atë moment, nuk i kishte dhënë rëndësi. Tani, kur kishte realisht nevojë për ndihmë, vendosi të hyjë. Takimi me Blerinën rezultoi thelbësor. Nuk ndjehej e sigurt të shkruante një CV pa eksperiencë pune. Por këshilluesja nuk u ndal tek ajo që mungonte, përkundrazi, nisi të bëjë pyetje për të nxjerrë në pah atë që kishte vërtet rëndësi.

"Tani isha aty, pa asnjë ide se nga t'ia nisja. Kur Blerina më pyeti nëse kisha përgatitur ndonjë CV, u ndjeva edhe më e pasigurt. "Çfarë mund të shkruaj? Unë nuk kam punuar kurrë." Por, këshilluesja e karrierës pikërisht për zgjidhjet profesionale befason: Më pyeti për gjithçka pëlqeja, trajnimet, pasionet që kurrë nuk do i kisha menduar se kishin rëndësi për një CV. Nuk më dha një formular të gatshëm për të plotësuar, por filloi të më bëjë pyetje që vetë nuk i kisha menduar: "Cilat janë pasionet e tua? A ke marrë pjesë në ndonjë trajnim? Çfarë të bën kurioze? Çfarë të motivon? A ke marrë pjesë në aktivitete gjatë periudhës së gjimnazit?"

Me ndihmën e saj, studentja përgatiti një CV të personalizuar dhe të saktë. Informacioni u përzgjedh me kujdes, u strukturua në mënyrë profesionale dhe u përshtat për vendin e praktikës. CV-ja nuk ishte më thjesht një listë bosh, ishte një histori e ndërtuar me vëmendje.

"Befas, unë kuptova: kisha çfarë të thoja. Kishte gjëra që më përfaqësonin, përvoja që ndoshta nuk ishin punë zyrtare, por që kishin formuar atë që isha. Ajo përzgjedhi ato më të rëndësishmet, i redaktoi, i organizoi dhe krijoi një CV që më përfaqësonte vërtet".

Dhe funksionoi. Studentja nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, u pranua për të bërë praktikën në televizion. *"Aty mësova më shumë seç kisha ëndërruar: si funksionon një emision live, si përgatiten pyetjet për të ftuarit, çfarë ndodh pas kamerave, si punohet në ekip dhe si krijohet ajo magjia që shfaqet çdo natë në ekran. Ishte një botë që gjithmonë më kishte tërhequr, por që tani po e përjetoja nga brenda".*

Shpesh studentët marrin një CV nga interneti, plotësojnë emrin, shkollën, dhe e dërgojnë. Por ajo që Anja sot tregon është se si mësoi nga Zyra e Karrierës përpilimin e një CV, i cili nuk është thjesht një dokument, por është një mënyrë për të treguar kush je, edhe nëse nuk ke ende shumë përvoja pune. *"Për ta treguar mirë këtë, ndonjëherë na duhet një profesionist që të na ndihmojë të shohim vlerat që mbajmë me vete pa i kuptuar".*

Anja sot e mbyll historinë e saj: *"Tani, nuk kaloj më thjesht përpara derës së asaj zyre. E di që brenda saj ndodhet një mundësi. Sepse ndonjëherë, mjafton një takim, një pyetje, një bisedë... për të hapur një rrugë të re".*

